

"PRISHTINA ENERGJETIKE"



Projekti "Dalja 4 - Dardania"

"Dalja 4 - Dardania" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

Të dhëna specifike për projektin: Hapja e kanaleve të reja në shtrirje prej 2 km. Do të përfshihen 21 transformatorë, vendosja e 11.3 km kabllove të reja të tensionit të mesëm.

Përfitues nga projekti "Dalja 4 - Dardania" : 3,182 konsumatorë

Lokacionet ku do të punohet: Rr. Xhemajl Mustafa; Rr. Ilaz Kodra; Rr. Tahir Zajmi dhe Rr. Sadik Bekteshi.

Periudha e zhvillimit të projektit: 2020 – 2021

Përfundimi i projektit: Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

